



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 2878/2 prot

Datë 21.11.2023

**FORMULAR PËR PUBLIKIM**  
**LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR**  
**VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR**

- Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “EN-BJO” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur, e thjeshtuar*”, me Nr. REF-83646-10-13-2023, me objekt: “*NSHP, BOJË FOSFORESHENTE*”, me fond limit 3,000,000 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 26.10.2023 nga autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, Bashkia Vlorë.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “EN-BJO” SHPK, me NIPT (K872172050), me adresë: Lagja “Pavarësia”, Bulevardi “Ismail Qemali”, Pallati Nr.458, Hyrja Nr.11, Kati 1, Vlorë
- Autoriteti Kontraktor:** Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, Bashkia Vlorë, me adresë: Lagjia, Kushtrimi; Rruga “Dervish Hekali”

Në datën 20.11.2023 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2023/3628, si dhe nr. protokolli 2878/2023 datë 20.11.2023 e operatorit ekonomik “EN-BJO” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur, e thjeshtuar*”, me Nr. REF-83646-10-13-2023, me objekt: “*NSHP, BOJË FOSFORESHENTE*”, me fond limit 3,000,000 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 26.10.2023 nga autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, Bashkia Vlorë.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “EN-BJO” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Bazuar në nenin 112, pika 4, gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon:

b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;”.

Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik “EN-BJO” SHPK kundërshton me anë të ankimit elektronik me nr. A/2023/3628, si dhe nr. protokollit 2878/2023 datë 20.11.2023. Konkretisht:

*Skualifikohet pasi nuk ploteson piken 2.3.4 Operatori ekonomik te paraqese mostra per te gjithë artikujt e prokuruar ditën dhe oren e hapjes së tenderit për të verifikuar nëse mostrat përputhen me specifikimet teknike duke paraqitur moster vetem për bojën e bardhë, me etikete prodhimi në dt 12/07/2022 dhe etikete skadence në dt 12/07/2023.*

*Nuk ploteson piken 2.3.3 Operatori ekonomik ofertues për mallrat objekt prokurimi duhet të paraqesë katalogun/et ose fragmente të katalogut/eve ose skedat teknike të mallrave objekt prokurimi duke paraqitur katalog vetem për bojën e bardhë dhe sipas tabelen Karakteristika Teknike të ky katalog shkruhet: E disponueshem e bardhë dhe e verdhë trafiku, duke mos e përfshirë bojën e kuqe dhe të zeze. Nuk ploteson Shtojcës 5 të specifikimeve teknike, është kërkuar pesha specifike  $1.75 \pm 0.10$  kg/ltd he është ofruar  $1,60 \pm 0,05$  gr/ml.*

Publikuar në regjistrin e ankesave më datë 21.11.2023.

## **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Kryetar**  
**Jonaid Myzyri**